



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës SH.A.
DREJTORIA TEKNIKE

Referuar urdhërit për fillimin e procedurës Nr. **2892/1** Prot. Datë 22.10.2018, me objekt :
“Ndërtim i puseve dublikantë”, rendis specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese dhe përlllogaritjen e fondit limit si më poshtë:

1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të ketë kryer a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Si dëshmi për punë të ngjashme kërkohet: kontratën/kontratat me Autoritetet Kontraktore publike apo private të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 8 të DST.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh duhet te paraqitet si vijon:

- Kontrata e Bashkim Operatoresh deklaruar ne fazen e tenderimit
- Prokura e posacme e Bashkim Operatoresh deklaruar ne faze tenderimi

Ne rast se kontrata e paraqitur eshte realizuar si Nenkontraktor duhet te paraqitet si vijon :

- Kontrata baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor
- Miratimi zyrtar si nenkontraktor zyrtar nga ana e autoritetit kontraktor

Nuk do të merret parasysh asnjë punim i pavërtetuar.

Për kontratat e realizuara me subjekte private, përveç dokumentave të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes (ku shprehen qartë data, shumat, sasi të, emërtimet dhe vlerat)

Nëse objekti i ngjashëm i paraqitur është ndërtuar me financim të vetë ofertuesit, ai duhet të paraqesë lejen e ndërtimit, situacioni përfundimtar, lejen e shfrytëzimit dhe faturat tatimore përkatëse.

Kontrata te ngjashme konsiderohen te vlefshme nese zerat kryesore te punimeve kane volume te konsiderueshme krahasimore me keto te përcaktuara per kete prokurim.

2. Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçencat e mëposhtme:

- NS.20 A - Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje.

3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të disponoi liçensat dhe lejet mjedisore për “Shpues profesionist per uje” të tipit III.7.B, për ndikimin në mjedis sipas legjislacioneve në fuqi ose kontratë bashkpunimi në prani të noterit ku të specifikohet objekti me një shoqëri të certifikuar për “Shpues profesionist per uje” e cila duhet të jetë e pajisur me liçensat dhe lejet mjedisore , III.7.B.

4. Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton që për 6 muajat e fundit duke marre si reference datën e hapjes së ofertës, të ketë të punësuar për këtë periudhë mesatarisht jo më pak se 6 punonjës (duke përfshire edhe stafin tekniko menaxherial). Punëtorët të jenë të deklaruar me kohë të plotë.

Për këtë, dokumentacioni që duhet të paraqesë është:

- a. Vertetim nga sig shoqerore apo dega tatimeve per numrin e te punesuarve dhe qe u jane paguar detyrimet për kontributet e tyre për muaj e periudhës së mësipërme ,
- b. Liste pagesat e konfirmuar nga administrata tatimore sipas formtit elektronik për muajt e kësaj periudhe.

4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre si më poshtë:

Inxhinier Gjeoinformatike	1 punonjës
Inxhinier Gjeolog	1 punonjës
Shofer te pajisur me leje drejtim	2 punonjës
Shpues profesonist	1 punonjës

Inxhinieret duhet te paraqesin diplome, Cv dhe kontraten para noterit me operatorin ekonomik te vlefshme .

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryeje të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarinimin e mësipërm.

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamioncina me vinc deri ne 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

Kamion mbi 4.5 ton	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
Autosonde : • <i>Lloji i automjetit :autosond shpimi</i> • <i>Numri i akseve: 3 akse</i> • <i>Pesha max fuksinale 25,5 ton</i> • <i>Lartesia operative jo me shume se 11,60 m</i> • <i>Kapaciteti i terheqjes max 60 ton</i> • <i>Thellesia ma e shpimit jo me shume se 1500 m</i> • <i>Diametri i kokes shpuese – nga 2” deri ne 22”</i> • <i>Diametri i tubit – nga 2” deri ne 22”</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
Autosonde me kompresor ajri: • <i>Lloji i automjetit : Autosonde per shpim per uje gjeologjike , puseshe dhe me kompresor te montuar ne shasi.</i> • <i>Kokat e shpimit nga 120 mm deri ne 800 mm</i> Te dhenat e kompresorit : • <i>Kohezgjatje qarkullimi 9146 m/h</i> • <i>Pesha 4200 kg</i> • <i>29 bar 22.00 litra</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
Autobot uji: • <i>Lloji i automjetit :kamion për për transport uji.</i> • <i>Numri i akseve: 2 akse</i> • <i>Elementet perberes:</i> - <i>kabinene e shoferit,</i> - <i>depozit uji jo me pak se 10m3,</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- b) Pranohet marrja me qera ose huapërdorje e mjetit me kusht kusht që kontratat të lidhen para noterit e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit ose të dhenat teknike që janë shënuar në shasin e mjetit.
- d) Mësimet e mësimëve nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).
- e) Për të provuar disponimin e pajisjeve të kërkuara, Operatori duhet të paraqesë faturën e blerjes së këtyre pajisjeve.

6. Për të siguruar përqëndrimin e plotë të Kontraktorit në objekt, Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet se, brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Sipas Shtojcës 11.

(Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.)

7. Afati i përfundimit të punimeve të jetë 40 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Grupi i hartimit të specifikimeve.

